

# albanian

by *shkëlqim kasa*

thanks to *shaip emërllahu*

director, "*ditët e naimit*" literary manifestation  
(*skopje - macedonia*)

copëza

nga *letrat*

djegur nga rrufeja

Kur mbi kokë të ka rënë rrufeja,

Mos prit të dëgjosh

Gjëmimin e bubullimës

1973

eseisti

Edhe sikur të gjithë të ndjenim aq shumë,

asnjë nuk do ishte realisht poet;

Që të bëhemi, vetëm për këtë,

Të gjithë mundohemi, vërtet

1999

inJORANCË

Asnjë nuk më njeh

Sa çanjoj unë veten time

Por e di,

dhe atë e njoh fare pak

1973

**dhembshuri**

Do të thotë:

Më voglën të keqe që i ke bërë dikujt ta kujtosh,  
Dhe më të madhen e të këqijave të tij ta harrosh  
1997

**shpata dhe pena**

Sàke pse rrëmben shpatën në duar  
Kur me penë ke dështuar  
1993

**profeci**

Do njeri është një profet,  
tek ai jeta fillon,  
tek ai jeta mbaron  
1988

**lumturia**

Nëse do të marrim:  
Nga politeizmi respektin e tokës dhe të të parëve,  
Nga lindja e largme spiritualizmin,  
Nga judaizmi vizionin dhe qëndrueshmërinë,  
Nga krishtërimi faljen dhe dashurinë,  
Nga islami ngrohtësinë e besimin,  
Nga laicizmi hapjen dhe kuptimin,  
Nga humanizmi përpjekjet unitare,  
Atëherë do të mund të bëheshim  
Më të lumturit e njerëzve  
1990

\*\*\*

**vizioni**

Duke u kujtuar që ora e integritit të shefave të tyre të vjetër kishte trokitur,  
besimtarët e kishin rrethuar për t'atë kërkuar rekomandimet e tij të fundit.  
Ai u tha: Lirohuni nga idetë, siç bëra unë me veten time që, kur isha 7 vjeç i  
dhurova një fëmijë të varfër të lagjes lodrën që kisha më për zemër sa që  
desh më bëri të harroja sensin e dhurimit.  
Lirohuni nga pasioni, siç bëra unë me veten time, që kur mbusha 17 vjeç  
sakrifikova dashurinë për miqësinë.

Lirohuni nga dija, siç bëra unë me veten time që, kur mbusha 27 vjeç pushova së koleksionuari diplomat, që më çonin drejt krenarisë dhe jo drejt turpit.

Lirohuni nga fama, siç bëra unë me veten time që, kur mbusha 37 vjeç e kuptova se jo ishte vetëm një mirazh.

Lirohuni nga konsideratat metafizike, siç bëra unë me veten time, që kur mbusha 47 vjeç i besova të vërtetën të vërtetës.

Lirohuni nga mondanitetet, siç bëra unë me veten time që, kur mbusha 57 vjeç u ndërgjegjësova për hipokrizinë e pjesës më të madhe të qëndrimeve njerëzore.

Lirohuni nga ngjashmëritë dhe jetoni në vetmi nëse, ashtu si dhe unë kur mbusha 67 vjeç, nuk më mbeti më asnjë shok besnik.

Lirohuni nga mendimet, siç bëra unë me veten time, që kur mbusha 77 vjeç, pushova së dhkruari dhe i grisa librat e mi që më kishin shmangur nga natyra.

Lirohuni nga trupi juaj sa më shumë që të mundni, sepse do vijë një ditë, që ju do çliroheni nga jeta që bëni dhe do të filloni një tjetër jetë që nuk e njihni ende...

1999

## copëza nga *i emancipuari*

### fladi

*(larg nga koha dhe vendi)*

Ja ku jam në mes të flladit që fryn përmes universit, pa asnjë kufi, kohe dhe vendi, duke i dhënë fund udhëtimit të tij të gjatë në mushkритë e një foshnjeje.

Papritur, jeta filloi të më dukej më e pranishme brenda vetes dhe tani më ngjan si një pjesë e imja.

1995

### melodia

*(në një tokë që rifitoi lirinë e saj nga njeriu)*

Duke luftuar për vdekje njëri kundër tjetrit, disa fise madje edhe u zhdukën, mbi një tokë që rifitoi lirinë; në kujtime mbeti vetëm një melodi, krijuar nga

një gjeni që ëndëronte të bënte me të një afrim mes armiqsh. Por më kot. Më në fund ishte natyra që me zogjtë, pemët dhe lumenjtë, filloi të këndonte melodinë e ekzistencës, atë të inteligjencës dhe të forcës.

Po, natyra filloi të më këndonte mua.

1997

#### poema

*(moment qetësie në brigjet e Vollgës)*

Kujtimi i një populli më çon tek një poemë pa autor, që thotë:

*Biri im,*

*Nëse një ditë do ndjesh mall për mua,*

*Kur me ikjen time solla mbitokësorët.*

*Jetoje me vrull jetën tënde,*

*Dhe kur të ndjesh integrimin tënd*

*Eja të më gjesh në shtëpinë time të vetmuar,*

*Tek qënia dhe tek asgjëja.*

*Do më gjesh aty lart*

*Para një cope letre me penën në dorë*

*Në kërkim të një përtëritjeje*

1997

#### shkëmbi

*(çast romantik në shkretërinën e Gobit në Mongoli)*

Ja ku jam, këtë herë i shndërruar në një shkëmb pa jetë, që kurrë më parë s'ka qënë kaq i afërt me një qenie njerëzore. Dy të dashuruar gdhendën mbi këtë shkëmb dashurinë e tyre, duke më bërë mua dëshmitarin e pasionit dhe të historisë së tyre.

1995

#### ndërgjegjia

*(dëshmi në kohë lufte)*

Më imponohet ai që dikur i imponohesha. Krah për krah, ne luftonim bashkë me kënaqësi gjatë adoleshencës dhe me tërbim gjatë rinisë. Duke zgjedhur karrierën politike si mjet ekzistence dhe duke mundur të bënte emër, arriti të hypte në pushtet me të cilin abuzoi. Pyetjes time: “Përse po e bën gjithë këtë dhe çfarë u bë me cilësitë e mira dhe luftën?”, ai e justifikonte me shtypjen e dikujt nga nevoja për të ruajtur favorët e fituara.

Atë ditë unë dorëzova dëshminë time.

1997

## lugati

*(larg kohës dhe vendit)*

Dhe më në fund kthimi bindës, larg kohës dhe vendit të caktuar, larg çdo sensacioni dhe çdo realiteti.

1997

\*\*\*

## madhështori

... Rreth shtëpisë së vetmuar të madhështorit endet Vdekja. Në fillim, duke parë itinerarin e një jete shembullore të plakut të vjetër, ajo e kursen. Madhështori, ka disa dëshira, dhe ajo ia plotëson. Madhështori vjen atëherë me një ndërveprim kozmik, njësoj si të gjitha qëniet para dhe pas tij, duke u bërë kështu një pjesë e kësaj të vërtete për të cilën ai pati bërë aq shumë me qëllim që ta frikësonte.

Familja dhe populli i tij vrapuan nga të gjitha anët për ti bërë homazhet e fundit njeriut madhështor. Disa, që gjetën një parfum temjani në shtëpinë e vetmuar, e shpallën shenjtor. Të tjerë, të bindur se panë një aureolë drite që vërshoi nga e njëjta shtëpi, e shpallën profet.

Dhe atëherë djali i madh, i djalit të madh të madhështorit hapi zarfin që mbante brenda dëshirën e fundit të gjyshit të tij, dhe ua lexoi me një zë të pastër të pranishmëve:

“Dëshira ime e fundit është skalitur në jetën time. Lexojeni dhe merrni shembull nga ajo. Mos e harroni kurrë që asnjë nuk është më i mirë se çdokush nga ju, ashtu si dhe çdokush nga ju nuk është më i mirë se të tjerët.

“Për sa më përket mua, nuk jam veçse një qenie njerëzore e thjeshtë, ndoshta i pari nga të emancipuarit dhe të integruarit; dëshira ime është të mos jem i fundit, duke ditur që nuk jam as i pari dhe as i fundit nga të gjithë të integruarit realisht.

“Le të jetë dita e nisjes time, festa e integritit drejt së vërtetës dhe emancipimit kozmik. Le të bëhet varri im, shumë thjesht në shtëpinë time të vetmuar dhe mbi pllakën e tij le të shkruhet: “Këtu prehet një njeri nga lugina e gjelbër”. Le të mbetet përfundimisht e hapur, ashtu si ka qenë gjithmonë, porta e shtëpisë time të vetmuar, pa prespektivë për tu restauruar, e braktisur dhe e prishur nga koha dhe nga kapriçot e natyrës.

“Të dashurit e mi, jini të lumtur për mua sepse cilado qoftë shtrirja e këtij vendi, inegzistenca e tij është akoma më e madhe, dhe cilado qoftë kohëzgjatja e tij, inegzistenca e tij është edhe më e gjatë. E njëjta gjë, cilado

qoftë plofuqia e sensacionit, inegzistenca e tij është gjithnjë e më shumë e efektshme, cilado qoftë gjerësia e reales, inegzistenca e saj është edhe më e pafundme.

Maj 1996

## copëza nga *i integruari*

### kërkuesi

E gjej natën duke rrëmuar nëpër koshat e plehrave; pasi e qortoj e braktis në fatin e tij të trishtueshëm...

Pastaj fillova të prisja ardhjen e këtij fatkeqi. Në fillim çdo natë, pastaj çdo mëngjes; dhe në fund çdo moment të ditës. Sepse miku ynë ishte mësuar me praktikën e nevojës së tij të trishtueshme, dhe në vend që të bënte punën e tij me siklet si në fillimet e tij, ai filloi të ushtronte rregull dhe profesionalizëm; deri në atë pikë sa që kur u takuam herën e fundit, kur shikimi i tij u kryqëzua me timin, isha unë që u mbulovala me turp.

1999

\*\*\*

### integrim

Tani që përfundoi dëshmia e ankuesit dhe puna e mbrojtjes, Zoti-Gjykatës, deri atëherë i heshtur, duhet të marrë fjalën për të dhënë gjykimin e tij.

Dhe ja, nga e çara që është njëkohësisht burg dhe hapësirë lirie, duket një dritë misterioze. Përmes asaj të çare, qetësia më fton të njihem me Zotin-gjykatës dhe të dëgjojë sentencën e tij. Afrohem kështu pa lëvizur, për të parë, me sytë mbyllur. Një pasqyrë e rreme më prezanton tek Zoti-gjykatës duke shqiptuar një pretendencë të bazuar mbi një ndërgjegje njerëzore, parrulla e të cilës është: Pafajësia; atëherë e kuptoj se jam para vetes time, dhe se kontraditat nisin të zhduken pak nga pak dhe se integrimi filloi.

Ja pra ku jam, njëkohësisht para profetëve dhe të mjerëve. Unë integrohem me ta dhe tek ata, integrohem me Zotin-Gjykatës dhe tek ai, sepse ne të gjithë kemi të njëjtin qëllim; ndërgjegjia në fakt është garancia e ekuilibrit njerëzor dhe jo shprehja e aspekteve të shumta të zhbëndjes.

Ja ku jam, përsëri në plotfuqinë, për të cilën kurrë nuk rreshta së bëri pjesë dhe në qënien dhe hiçin që nuk i braktisa asnjëherë.

Ja ku jam, madje duke qënë një pjesë përbërëse e plotfuqisë, e qënies dhe e asgjësë, sepse grimcat nuk janë të sigurta pas vdekjes.

1998

\*\*\*

ai që niset

Pas një kthimi nostalgjik nga toka, vendi i një jete të mëparshme, unë vazhdoj të bëj udhëtim tim të gjatë.

Jetoj vazhdimisht me kujtimet e mia tokësore, edhe pas kthimit. Kështu që unë vazhdoj të vozit, pa asnjë kufizim, në kohë dhe në hapësirë.

Nëse evoluoj në njohjen absolute dhe në të vërtetën universale, duke u nisur në zbulim të një përtëritje dhe të asaj që heq dhe do të heqë Njeriu, një preokupim më grryen gjithmonë mendjen: ai që ka të bëjë me Njeriun, me jetën e tij të përditshme, me të ardhmen e tij, me mirëqënien dhe lirinë e tij.

Sepse pa Njeriun, çfarë kuptimi do të kishte jeta dhe vdekja? Cili do të ishte kuptimi i plotfuqisë me të dyja faqet e saj: njohjen dhe të vërtetën?

Dhe do të pyesja veten: Përse lumturia e njeriut mbi tokë është e paarritshme?

Duke besuar, unë jam futur në jetën e Njeriut, brenda mbitokësore meqë unë kam hyrë tashmë brenda vetes.

Po çabëhet me jetën e tij mbi tokë? A është e mundur që të përmirësojmë kushtet e kësaj jete?

Si mund t'ia bëjë prej aty ku jam?

Vetëm vdekja i jep fund urisë dhe lakmisë, ëndërrimit që bën i devotshmi dhe kokëkrisuri, shqetësimit të njohësit dhe të injorantit. Vetëm vdekja vendos përfundimisht barazinë mes nesh.

Tema që më preokupohe më shumë është Njeriu... Por a nuk jam unë vallë në integrim të plotë me Të dhe me Universin, larg kohës dhe vendit, në jetë dhe në vdekje? Atëherë përse vallë shqetësohem unë?

Unë u nisa, mësohuni me çdo lloj shprehje, e shkruar apo e pashkruar qoftë ajo. Unë po iki, mësohuni me Njerëzimin, me problemet dhe hallet e tij. Unë ika, emancipohuni duke i thirrur emancipimit, për të njohur absoluten dhe të vërtetën universale. Ai që ikën është Njeriu, i çliruar nga Zoti dhe nga Universi. Ai që ikën më në fund është Zoti i Universit, i çliruar këtë rradhë nga Njeriu.

Unë jam ai që ikën; ai që ikën është Njeriu, ai që ikën është Zot i Universit.  
I lirë, unë jam i lirë, i lirë është Njeriu dhe i lirë është Zoti i Universit.  
1999

## copëza nga *ëndërrimtari*

### i fundit

... Në çastet e fundit të jetës së tij, ëndërrimtari, pas disa mendimesh të pjekura, arriti në konkluzionet e mëposhtëme:

Zoti lind, rritet pastaj plakët në mendjet e njerëzve. Ata që e krijojnë në përfytyrimet e tyre, mendojnë se Zoti e krijoi Njeriun vetëm për tu zbavitur; ata i përkushtohen me rradhë argëtimit. Nga ana tjetër, ata që i tremben e bëjnë duke harrur edhe të jetojnë. Në kërkim të një Zoti të krijuar në përfytyrimin e tij, duke u plakur në kohë dhe në hapësirë, dhe duke humbur në qënien dhe asgjënë, Njeriu harron kështu që vdekja i fshin të gjitha njëherazi dhe e integron totalisht tek ajo që ai kërkon ose që nuk e ka kërkuar akoma.

Njeriu, kjo qenie mendimtare, duke pasur frikë nga vdekja, trembet akoma më shumë. D.m.th ai nuk mund të ketë një akses drejt emancipimit dhe integritetit, aq thjesht sa elementët e tjerë të natyrës dhe të universit. I takon atij të riaktivizojë arësyen për të asimiluar këto dy nocione.

Përveç kësaj, duke ëndërruar për jetë pas jetës, ai e imagjiron në mënyrë identike me atë që njeh, dhe mbi të gjitha të përjetshme. Por në këtë rast a nuk do të ishte monotone? Po njeriu, vetë ai, nuk do të shndrohet në Zot?

Duke kërkuar besimin, njeriu largohet nga ngjashmëritë duke iu kundërvënë atyre. Mos duhet që me këtë rast ai të afrohet me veten dhe me njerëzimin, duke besuar në vlerat e tij të mëdhaja?

Për sa i përket besimit, sigurisht që ai përbën mjetin më të mirë të shpëtimit - por të një shpëtimi të pasigurt - kur vullneti i të vepruarit në të mirë të njerëzimit është rruga më e sigurt.

Deri dje, Njeriu duronte praninë e natyrës më shumë se sa donte veten. Sot, Njeriu e përdor natyrën dhe abuzon me të. Gjer atëherë, ai kishte ruajtur egzistencën e tij në një të kaluar historikisht me një zhvillim të ngadalshëm.

A do të mund ta ruajë kaq mirë në një botë, që tashmë po evoluon, me një shpejtësi të madhe?

Shkurt, duke përfunduar, ëndërrimtari që nuk ka asnjë të ardhme për një njerëzim të që përçahet vazhdimisht në vetvete, për sa i përket diferencave të racave, të gjuhëve, të territoreve, të besimeve dhe të dogmave; i bashkuar vetëm nga lakmia, duke i dhënë fund çdo nocioni të humanizmit.

2000

\*\*\*

### *Kantikat*

9

Unë jam i sapo linduri, adoleshenti,  
Unë jam plaku, vazhdimësia,  
Unë jam babai, lodhja,  
Unë jam nëna, përjetësia

Unë jam i pajeti, jam lëvizja,  
Unë jam kultura, jam kujtimi,  
Unë jam e mira, jam dhurata,  
Unë jam e keqja, jam mjerimi

Unë jam mëshira, dashuria,  
Unë jam urrejtja, pakënaqësia,  
Unë jam shpresa që shpreson,  
Jam fati që ti kërkon

Jam e vërteta, jam mendimi,  
Jam lakmia, jam besimi,  
Jam i dukshmi që dallon,  
Si çdo yll që fluturon

Unë jam jeta, unë jam vdekja,  
Unë jam qënia dhe mosqënia,  
Unë jam Zoti, pavdekësia,  
Jam asgjëja, gjithësia

Unë jam Njeriu  
2000

10

Naji Naaman

11

Unë egzistoj, pra jam i përgjegjshëm;  
Ti egziston, pra edhe ti je;  
Ne egzistojmë, pra edhe ne jemi;  
Rastësia na bashkon, solidariteti na obligon;  
Për të mirë e për të keq,  
Detyra na thëret  
2000

copëza  
nga *alfa-omega*

nga *ai që ikën*

vetëm kohë e humbur  
Duke u përkundur nga iluzionet  
Me shpresën e një takimi ose të një puthjeje;  
Vetëm kohë e humbur  
Duke imagjinuar të pamundurën dhe duke ëndërruar;  
Vetëm kohë e humbur  
Mbi tokë, në det dhe në ajër,  
Duke dashur të udhëtojë;  
O Zot, megjithëse kam aq shumë mall  
Për këtë kohë të humbur kot!  
2002

për jetën  
Kur rrugën e kthimit marr,  
Dhe kur provoj të kuptoj dhe të analizoj,  
Jo pa filozofi,  
Kam shumë më tepër pyetje se përgjigje  
2002

lotët e fundit

Fillojnë të rrjedhin:

Janë lotët e nisjes;

A do të jenë të trishtuara dhe të nxehta,

Ashtu siç është ndarja?

Apo të gëzueshëm dhe melodiozë

Ashtu siç është zhvillimi?

Lotët e fundit filluan të rrjedhin,

Si një përrua,

Ja tek më nxisin të hypi në anije,

Dhe unë hipa

Me një gëzim të papërshkruar!

Unë ia marr lehtë një kantike,

Një kantike nisjeje që nuk e shkruajta kurrë,

Ja mora për herë të parë,

Kur forcat e mia më tradhëtuan

Për të fundit herë;

Gjithmonë ia marr lehtë,

Me shpresën se në fund do të mund të iki,

Ia marr gjithmonë lehtë

Dhe ja ku u nisa

Dhe ja në mes të gëzimit, duke kërcyer!

2002

\*\*\*

nga *interlokutori*

kaini

Çfarë bëre Kain, ose ç`bëri Njeriu me ty? Ti e vrave vëllanë tënd, apo ishte Njeriu që të ngarkoi ty fajin për vrasjen e tij pasi të kish përfytyruar në imagjinatën e tij?

Nëse do të jetë e vërtetë, se Zoti preferoi Abelin para teje, duke pranuar dhuratat e tij, ndërkohë që refuzoi të dhuratat dhe dashurinë tuaj për Të, dhe nuk ia diti për punën tënde të vështirë, unë jam gati të të jap disa rrethana lehtësuese, ty, o qenie e dobët sa në planin mental ashtu dhe në atë fizik. Por nëse do të kishte qenë Abeli që do të të kishte vrarë me gjithë ato prova dashurie që Zoti i kishte dhënë, unë nuk do t`ia kisha falur kurrë.

2002

**mëshira**

E gjeta, atje poshtë, të kryqëzuar. E gjeta, atje poshtë duke shtyrë sakrificën e tij deri në vdekje për të shpëtuar një tjetër. Pikë shkëmbimi mes ne të dyve, meqënëse bashkëjetojmë tashmë.

2002

**mullinjte**

Jam në kërkimin tënd që prej shumë kohësh, Servantes, por gjej vetëm Don Kishotin që kalëron Rosinantin duke ecur drejt mullinjve me erë, i ndjekur nga Sançoja, shoqëruesi i tij besnik, hipur mbi gomar.

I dashur Miguel, ti e bërë Don Kishotin të pavdekshëm në mendjen dhe imagjinatën e njerëzve, dhe shumë mirë; sepse mendoj se je keq, në kërkim të një aventure të re për heroin tënd, që nuk është askush tjetër veç teje.

Ne na takon aventura, ne të dyve na takon të zbulojmë me Don Kishotin dhe me Sançon!

2002

**dag**

Ti ke qënë i dyti që u bërë sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të bashkuara, Hamarskjold. Ardhur nga Suedia, vend që nuk e kishte njohur luftën që prej shumë kohësh, ti kishte për detyrë të konsolidoje, aq sa të mundje, paqen nëpër botë. Njeri i detyrës, ti veproje me një sukses të madh në të mirë të autonomisë së vendimeve të organizatës. Por tani, sa keqardhje dhe nostalgji për këtë organizatë, që tani është bërë flamur-mbajtësja e njëanshmërisë dhe e mendimit unik.

2002

**djemtë**

Djemtë e tu, Xhorxh Uashington, o liberador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës; o ti që punove me integritet dhe paanësi për një njerëzim më të mirë, shikoji djemtë e tu, dy shekuj mbas ikjes tënde, dhe megjithë rrugën e përshkuar që atëherë, shikoji se si i pushtojnë hapësirat deri në Mars, në kërkim të burimeve akuatike, duke e lënë ujin e bollshëm të tokës së paracaktuar të ndotet dhe duke dënuar miliona njerëz fatkeqë të vdesin nga etja!

A janë këta djemtë që ti ke dashur të jenë Uashington?

2002

## copëza *kujtimesh*

nga *hyrja*

Biri im,

Sa herë ma ka përsëritur gjyshi yt se shifrat po e vrisnin. Me këtë donte të thoshte se puna e tij administrative që bënte si kontabël, po e largonte nga shkrimet.

Përsa më përket mua, do të thosha se janë shkronjat që më vranë, sepse e vura pjesën më të madhe atje ku nuk duhej, domethënë te veprat jo-letrare. Sigurisht që këto u bënë të nevojshme dhe i pëlqyen shumë njerëzve; ato më dhanë edhe mundësinë të fitoj bukën e gojës. Por ato më larguan nga shkrimet letrare, që vetëm ato, përbëjnë një thesar krijimtarie.

Ti, që je në kërkim të emancipimit,

Duhet ta dish se çdo qenie njerëzore ka rrënjët e veta për të cilat duhet të jetë krenar, cilat do qofshin ato; me kusht që të mbahemi fort pas cilësive të mira dhe të braktisim të metat.

Rrënjët e tua ngjiten drejt tokës së profetëve, të apostujve dhe të shenjtorëve. Nuk dua të flas vetëm për këta, se ata njihen, por prej këtyre profetëve, apostujve dhe shenjtorëve të dhënë pas dijes dhe kulturës, çdo njeri ka jetuar jetën e vet, sipas vlerave të njohura në kohën e tij.

Rrënjët e tua biri im, janë në Lindje, në qendrën e tokës:

Aramenët, zbuluesit e zotit unik El, të dhanë emrin, sepse Naaman ishte shërbëtori i El. Naamani Sirian, shefi i ushtrisë aramene, ai u shërua nga lebra në shekullin e IX para erës së re, nga profeti Elize, duke u larë shtatë herë në ujrat e lumit Jordan. Për më tepër, Arameni u bë gjuha e vetë Krishtit.

Ti je gjithashtu, biri i Fenicisë së Kananeonëve, shpikësit të shkrimit, të cilin nuk e ruajtën dot për shumë kohë për vete, por u pasuruan me qytetërimin e të tjerëve, duke humbur kështu identitetin e tyre.

Ti je gjithashtu, biri i arabëve që luten me shpirt për drejtësi në qëndrimet e tyre të lavdimshme, tani më pak të dukshme dhe me pak shpresë për ti parë të rilindur një ditë.

Ti je biri i Libanit, që mbarëvajtja është shembullore në shkallë individuale, por jo në shkallë kombëtare për shkak të merkantilizimi të përgjithshëm.

Ti je gjithashtu biri i një kishe orientale, rrënjosur në histori, ndonëse e ndarë, këngëtarët e tyre i këndojnë gjithmonë himne kishtare lavdisë së Zotit.

Le të jemi krenarë, biri im. Merr përsipër dhe kujtohu vazhdimisht dhe para së gjithash, që ti je njëkohësisht biri i momentit dhe i mbarë njerëzimit.

Dhe mos harro që ti je bir i një familjeje, pjesëtarët e së cilës nuk kanë shtypur kurrë njeri.

Sepse Njeriut i mjafton, edhe pa shtypur të tjerët në kuptimin më të gjerë të fjalës, për të jetuar plotësisht jetën e tij. Çliroje ndërgjegjen tënde edhe po të jesh në burg, ku ti po mykesh pas një gjykimi të padrejtë, në vend që ta ngarkosh duke u gëzuar padrejtësisht për lirinë...

1998

## الثقافة بالمجان

### Ath-Thaqafa bil Majjan

*Série littéraire gratuite établie et dirigée depuis 1991 par*  
 Free of charge literary series established and directed since 1991 by  
*Serie literaria gratuita establecida y dirigida desde 1991 por*  
 Naji Naaman

**najinaaman**  
**an-najiyyat**

AN-NAJIYYAT

النَّجِيَّات

